

Albanian Bulletin

November 2015

Tax & Legal update Tax & Legal amendments January – October 2015

The Albanian Parliament has adopted a series of amendments to the existing fiscal legislation as well as introduced new laws in the attempt to support and improve the commercial and business activity in the country. The following Laws and Instructions have been amended or introduced as new:

- Joint instruction (Ministry of Finance and Ministry of Economy) no. 17, dated 12 June 2015 “On the approval of the list of goods and services subject to the VAT exemption when used for the research operations in the hydrocarbon activities”
- Decision no. 6/4, dated 04 September 2015 “On some changes on Decision no. 6, dated 30.1.2015 “On VAT”, as amended.
- Decision no. 953, dated 29 December 2014 “On implementing dispositions of law no.92/2014, “On VAT”
- Law no. 90/2015 “On some changes on law no.92/2014 ”On VAT”
- Decision no. 653, dated 22 July 2015 “On some changes on Decision no. 77, dated 28 January 2015 “On the obligatory collection of the social and health contributions in Albania.”
- Law no.66/2015 “On the remission of fines for unpaid social and health contributions”.
- Decision no.77, dated 28 January 2015”On the obligatory collection of the social and health contributions in Albania.”
- Law no. 156/2014 dated 27 November 2014 “On some changes in law no. 8438 dated 28.12.1998 “On income tax”, as amended”

- Decision no. 14/1, dated 04 September 2015 “On some changes in Decision no. 24, dated 02.09.2008:“On tax procedures in Albania”, as amended.
- Law no. 91/2015 on some changes “On law no. 9920, dated 19 May 2008: “On tax procedures in Albania, as amended.
- Law no. 99/2015 “On some changes on law no. 9920 dated 19 May 2008 “On tax procedures in Albania”, as amended
- Decision no.24, dated 11 September 2014 “On some changes on Decision no. 25, dated 30.11.2007 “On procedures for customs value review, information resources and deadlines of file publication with the data available on the customs clearance of vehicles and their spare parts”
- Decision no. 9, dated 27 February 2015: “On agreements on advance pricing”
- Decision no. 4, dated 30 September 2015 “On the average cost of construction of the buildings for year 2015”.
- Decision no. 469, dated 03 June 2015 “On determining the minimum value of the reference price of building leases for tax purposes”
- Decision no. 434, dated 20 May 2015: “On setting standards for spillages, losses, damages during the production, storage, transportation etc. for tax purposes”.
- Law no.6/2015 dt 12 February 2015 “On some changes in law no.10081 dated 23 February 2009: ” On licenses, authorizations and permits in the Republic of Albania "
- Law no.67/2015: “For Eurobond to be issued by the Minister of Finance, approval of exemptions from taxes and fees and provisions for resigning the immunity in the agreements concluded by the Minister of Finance ”.
- Law no. 54/2015 dated 28 May 2015 on some changes on law no.9789 dated 19 July 2007: “On the establishment and operation of Economic Zones”.
- Decision no. 15, dated 18 May 2015 “On determining the procedures for providing information by every person, in accordance with International Agreements in the field of taxation”
- Law no 8/2015 dated 19 February 2015 “On some changes in law no. 9723 dated 03 May 2007 On National Registration Center”, as amended

The purpose of this Bulletin is to summarize the above changes to tax legislation.

Please be advised that this summary is not intended to be exhaustive for its users but due to the high number of changes and also to the ongoing changes in the tax and related legislation you would find in this edition a series of new laws introduced and amended, which all need appropriate attention from your part.

Joint instruction (Ministry of Finance and Ministry of Economy) no. 17, dated 12 June 2015 “On the approval of the list of goods and services subject to the VAT”

The supply of the services and the import of goods related to the research phase in hydrocarbon activities from the contractors and their sub contractors are exempted from VAT.

The instruction specifies the list of the goods and services subject of VAT exemption as below:

- a) The supply of services to the hydrocarbon research phase conducted by research hydrocarbons companies (contractors) and their subcontractors, who on the basis of an agreement petroleum hydrocarbon perform search operations for new deposits of oil and gas.
- b) Import of goods and services included in the value of the goods subject to customs procedures for operations in point a).
- c) Supply of goods for realization of the research phase that contractors make to each other or to their subcontractors, imported as exempt from VAT, in pursuance of paragraph 39 of Article 56 of the Law on VAT.

The exemption is not provided for the supply of goods and services which are not directly related to the research operations, such as: internet, phone, accommodation, legal and financial consultancy services, and construction of own offices, transport, insurance, physical security services, etc.

Udhëzim nr. 6/4, datë 4.9.2015: Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Sikurse përcaktohet në nenin 1 të ligjit nr. 90/2015, datë 23.7.2015, “Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, procedura e rimbursimit të TVSH-së kryhet siç përcaktohet në ligjin për procedurat tatimore dhe udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar” ”.

Neni 63, “Rimbursimi për marrëveshjet financiare” ndryshon si më poshtë:

“Në rastet e parashikuara në pikën 2, të nenit 77 të ligjit, nëse kërkesa për rimbursim është bërë në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, tatimi mbi vlerën e shtuar u rimbursohet financuesve të huaj nëpërmjet sistemit të thesarit brenda 30 ditëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim. Rimbursimi i kryer për këto raste nuk i nënshtrohet analizës së riskut dhe kontrolli tatimor për rimbursimin e kryer nuk është i detyrueshëm përpara rimbursimit.

Çdo procedurë për rimbursimin apo për financimin e TVSH-së për rastet e mëposhtme, pavarësisht nëse kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo financohen sipas procedurave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 12.8.1996, nga përfituesi vendës, do të përfundojë brenda 30 ditëve, përfshirë edhe rimbursimin e shumave nga strukturat përgjegjëse të Thesarit.

VENDIM Nr. 953, datë 29.12.2014 PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Perjashtimi nga TVSH-ja ne import

Përfshihen nga TVSH-ja në import, makineritë dhe pajisjet që janë direkt të lidhura me investimin të kryera prej personave të tatueshëm të cilët:

- a) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë;
- b) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e përpunimit aktiv pavarësisht nga vlera e investimit;
- c) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit;
- ç) i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre;
- d) përfshihen nga TVSH-ja importimi i makinerive bujqësore.

Kufiri minimal i regjistrimit per TVSH

Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 5 milionë (pesë milionë) lekë në një vit kalendarik

Kufiri minimal i regjistrimit per TVSH – profesionet e lira

Personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe kryejnë veprimtari ekonomike në fushën e hotelarisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero dhe të gjithë janë persona të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit.

Dispozita per organizatat jofitimpruese

Furnizimet me karakter shoqëror, edukativ, kulturor, sportive përfshihen nga TVSH-ja kur kryhen nga organizma publikë apo nga organizata pa qëllim fitimi me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim nga TVSH-ja, me kusht që çmimet e furnizimeve që ofron organizata jofitimpruese të jenë më të ulëta se ato që ofrohen për furnizime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së, me qëllim që të mos sjellë shtrembërim të konkurrencës.

Zbatimi i përjashtimit nga TVSH-ja kërkon të plotësohen tri kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

- Organet drejtuese të organizatës nuk duhet të kenë interesa të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës.

- Veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) e organizatës duhet të mbizotërojë dukshëm në raport me pjesën tjetër të veprimtarisë, duke marrë në konsideratë të ardhurat përkatëse, duhet të kenë epërsi të ardhurat nga veprimtaria joekonomike e organizatës.
- Furnizimet që kryhen nga organizatat jofitimprurëse nuk duhet të konkurrojnë sektorin tregtar fitimprurës. Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e organizatës si veprimtari dytësore e saj, e kryer prej këtyre organizatave për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse, për të cilën janë krijuar, të arkëtuara gjatë vitit kalendarik, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës. Nocioni i “të ardhurave të përgjithshme” përmbledh të gjitha burimet financiare të organizatës, përfshirë të ardhurat nga furnizimet dhe subvencionet e shfrytëzimit.

Ligj nr. 90/2015: Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Afatet e rimbursimit të TVSH-se

Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, administrata tatimore kryen procedurën e rimbursimit, siç përcaktohet për këtë qëllim në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Administrata tatimore, para se të procedojë një kërkesë për rimbursim të TVSH-së për një person të tatuashëm, ka të drejtë ta detyrojë atë person të provojë që qëllimi i veprimtarisë ekonomike është realizimi i transaksioneve të tatuashme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së.”

Vendim nr. 653, datë 22.07.2015: Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.01.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Kontributet e paguara nga personat e vetëpunësuar dhe punetoret e shtëpie

Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulantë, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 4 696 (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

Për personat që punojnë si punëtorë shtëpie, punëdhënësi të deklarojë dhe të paguajë kontribut minimal mujor në shumën 3 948 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 748 (shtatëqind e dyzet e tetë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 38 400 (tridhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve që banojnë në rrethet

Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 29 400 (njëzet e nëntë mijë e katërqind) lekë.”.

Ligji nr. 66/2015 “Për faljen e gjobave për mospagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridike dhe fizike”.

Falen, në masën 100 për qind, gjobat e lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë evidentuar deri më 31 dhjetor 2014, në zbatim të neneve 113, “Mosdeklarimi në afat”, pavarësisht vlerës së detyrimit, dhe 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për subjektet juridike dhe fizike, kur kontributi dhe kamatëvonesa është paguar plotësisht deri në datën 30 shtator 2015.

VENDIM Nr. 77, datë 28.1.2015 PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SIGURIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Perjashtimi i shtetasve të huaj nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror

Nga mbrojtja dhe sigurimi i detyrueshëm shoqëror përjashtohen shtetasit e huaj që:

- 1) punojnë në subjekte të huaja, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare;
- 2) janë të punësuar në subjekte të huaja, që nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të kualifikuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor. Zgjatja e kohës së qëndrimit dhe shërbimit është sipas përcaktimeve në ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”;
- 3) janë të punësuar në subjekte të huaja, të cilat nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët dërgohen në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të caktuar, sipas një kontrate të lidhur nga subjekti i huaj punëdhënës me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor, kur plotësohen kushtet, si më poshtë vijon:
 - i) Të ketë një marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, të lidhur midis shtetit shqiptar dhe shtetit të subjektit punëdhënës të huaj;
 - ii) Procedura e regjistrimit, leja e punës dhe kohëzgjatja e saj të jenë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”;
 - iii) Rezidenca dhe detyrimet për pagesë, sipas legjislacionit fiskal, të zbatohen sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - iv) Subjekti kontraktues, i regjistruar në organet tatimore shqiptare, kërkon çdo 3 muaj, nga subjekti punëdhënës i huaj, dokument të konfirmuar nga strukturat e sigurimeve shoqërore të shtetit përkatës lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të shoqëruar me listën

emërore të punonjësve të huaj, të cilën e administron së bashku me dokumentet e transfertave në favor të punëdhënësit të huaj.

ç) me rezidencë e banim të përhershëm jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë veprimtari të regjistruara në emrin e tyre në të dyja shtetet ku kryejnë detyrën e administratorit, së bashku me një administrator tjetër, me rezidencë të përhershme në Shqipëri. Në këtë rast, personat do të jenë subjekt i mbrojtjes dhe i sigurimit të detyrueshëm shoqëror në atë shtet ku kanë rezidencën dhe, njëkohësisht, të vërtetojnë me dokument mbrojtjen me sigurim shoqëror nga shteti përkatës. Rezidenca e ka kuptimin sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9920, date 9.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

d) që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur midis shtetit të tyre me shtetin shqiptar.

Perjashtimi nga kontributet e kujdesit shëndetësor

Përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme të sigurimit të kujdesit shëndetësor personat ekonomikisht aktivë, që nuk janë me banim të përhershëm në Shqipëri, që janë të punësuar, të vetëpunësuar, punonjës të papaguar të familjes dhe personat me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe burime të tjera të krahasueshme.

Paga bruto maksimale dhe minimale per efekt te llogaritjes se kontributit te sigurimeve shoqerore

Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë, si më poshtë vijon:

- a) jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe deri në 97.030 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) lekë, për personat e punësuar;
- b) jo më pak se sa paga minimale, e barabartë me 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri 97 030 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) lekë, për personat e vetëpunësuar;
- c) e barabartë me pagën minimale mujore prej 22 000 (njëzet e dy mijë) lekësh, për punonjësit e papaguar të familjes.

Paga bruto minimale per efekt te llogaritjes se kontributit te kujdesit shendetsor

Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë, si më poshtë vijon:

- a) jo më pak se sa paga minimale, e barabartë me 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;
- b) sa dyfishi i pagës minimale, e barabartë me 44.000 (dyzet e katër mijë) lekë, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuar punon e bashkëjeton ligjërisht;
- c) paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, është 4 620 (katër mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë.

LIGJ 156/2014 Date 27.11.2014 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR

Tatimi ne burim

Dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huatë, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, të ardhurat nga lojërat e fatit, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera, që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, taten me 15 për qind. Gjithashtu kalimi i se drejtes se pronesisë mbi pasurine e paluajtshme taten me 15%.

Tatimi ne burim per te gjitha rastet e tjera eshte 15%

Deklarata vjetore individuale e te ardhurave

Plotësimi dhe paraqitja e deklaratës vjetore individuale të të ardhurave në administratën tatimore bëhet jo më vonë se data 30 prill e çdo viti për të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës. Nëse tatimpaguesi rezulton me pagesë, pagesa e tatimit kryhet jo më vonë se data 30 prill

Amortizimi i aktiveve te biznesit

Dy kategoritë e mëposhtme të aktiveve amortizohen me metodën e vlerës së mbetur, në bazë të një sistemi grupimi, me përqindje, si më poshtë:

a) Kompjutera, sisteme informacioni, produkte "software" dhe pajisje të ruajtjes së të dhënave me 25 për qind.

b) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20 për qind.

Në rastin kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10 % e kostos historike të këtij aktiviteti, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm i periudhës tatimore

Shpenzimet e pazbritshme – faturat e shërbimit me tatim ne burim te papaguara ne fund te vitit me

Nuk do të njihet si shpenzim i zbritshëm për efekte tatimore, shpenzimi për shërbime që janë kryer nga persona të tretë, nëse brenda datës 20 janar të vitit pasardhës nuk është paguar tatimi në burim për ato shërbime, pavarësisht nga fakti nëse është paguar ose jo vlera e faturës. Në rastet kur këto shërbime janë kryer nga persona jorezidentë të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, zbatohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve. Kjo do të thotë, se njihet si shpenzim i lejuar, vlera e faturave të pranuar për shërbime të kryera nga persona jorezidentë për të cilat, në zbatim të marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë, nuk është mbajtur tatim në burim

Shpenzime te lejuara per efekte fiskale – fondet e pensionet dhe firot

- Në rastet kur punëdhënësi ka krijuar një fond pensioni për punëmarrësin, kontributet e paguara prej punëdhënësit në fondin e pensionit për llogari të punëmarrësit nuk janë pjesë e së ardhurës së tatueshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat

personale. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

- Njihet si shpenzim i zbritshëm për efekte fiskale:

a) Firot e miratuara sipas VKM-se nr. 434 date 20.05.2015

b) Shpenzimet për kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional deri në shumën e përcaktuar me ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", për çdo punëmarrës

Llogaritja dhe pagesa e kesteve paraprake të tatimit fitimit

Tatimi mbi fitimin paguhet çdo tremujor ose çdo muaj në formë paradhënie gjatë vitit, bazuar në këste mujore.

Administrata tatimore, bazuar në të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës, dorëzuar nga tatimpaguesi brenda datës 31 mars të vitit vijues, llogarit këstet mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin për periudhën prill – dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm.

Kërkesa për uljen e kesteve të tatimit fitimit nga tatimpaguesi

Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë gjatë periudhës tatimore (në çdo muaj të vitit), vërteton se tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e kesteve të paradhënies të tatimit mbi fitimin të vendosura.

Si fakte të cilat mund të argumentojnë kërkesën për uljen e kesteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin mund të merren:

- Shitjet gjithsej të realizuara dhe të deklaruara nga tatimpaguesi, për muajt e kaluar të vitit vijues, në raport me shitjet gjithsej të dy viteve të mëparshme. Nëse këto shitje janë ulur në mënyrë të dukshme, administrata tatimore pranon uljen e kesteve proporcionalisht me uljen e vëllimit të shitjeve.

- Mungesa në vijim e kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kesteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin.

- Mbarimi i kontratave mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, përfundimi i objekteve apo punëve të tjera publike të kryera.

- Fatkeqësi apo dëme të tjera që mund t'i kenë ndodhur tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në uljen e volumit të veprimtarisë së tij ekonomike.

- Mbyllja e linjave, veprimtarive të caktuara, shkurtimi i ndjeshëm i fuqisë punëtore si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.

Tejkalimi i të ardhurave vjetore në raport me keestet e parapaguara të tatimit fitimit

Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit.

Detyrimi për dorëzimin e vendimit të organit kompetent dhe bilancit

Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të tatimit mbi fitimin, brenda datës 31 korrik të çdo viti, depozitojnë pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore (përfshirë edhe rezervat e krijuara në përputhje me statutin e shoqërisë), pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë të kapitalit dhe pjesën që do të shpërndahe në formë dividendi

Tatimpaguesit e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin, pavarësisht nga përjashtimi, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin vjetor, në të njëjtat afate si tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

Udhëzim nr. 14/1, datë 4.9.2015: Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Publikime të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet strukturave të saj që ndjekin çështjet tatimore pranë organeve gjyqësore, publikojnë në linkun e krijuar posaçërisht, për këtë qëllim, në faqen zyrtare të internetit, vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Leshimi i kuponit dhe fatures tatimore pavarësisht nga statusi i blesit

Subjekti shitës me pakice, subjekt i TVSH-se apo i tatim fitimit, është i detyruar të leshojë përveç kuponit tatimor dhe fature TVSH-je në rast se kryen shitje me vlerë mbi 40,000 Lek përfaqëse TVSH-ne, pavarësisht nga statusi i blesit.

Detyrimi për kase fiskale

Tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave ose shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të përdorin sistemin fiskal nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin në mënyrë të detyrueshme të kuponit tatimor.

Tatimpagues në sektorë të veçantë të ekonomisë, siç përcaktohet në VKM-në janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sisteme të monitorimit të qarkullimit.

Detyrimi me vlerë 100 leke

Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, sipas deklaratës tatimore, me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlere zero dhe për shuma të tilla nuk bëhet vlerësim tatimor nga administrata tatimore.”.

Menyrat alternative te vleresimit tatimor

Si baze per zbatimin e menyrave alternative te vleresimit te detyrimeve tatimore, autoritetet tatimore mund te perdorin:

- çmimet sipas të dhënave të disponueshme në doganë ose çmimet e referencës së shitjes me pakicë që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,
- të dhëna për çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme dhe çmimet e referencës së qirave

E drejta e vleresimit tatimor

E drejta e administratës tatimore për të bërë vlerësim tatimor, si dhe e drejta e tatimpaguesit për të kërkuar tepricën kreditore te tatimit parashkruhet brenda 5 vjetesh nga data e dorezimit te deklarates tatimore perkatese.

Procedura e rimbursimit te TVSH-se

Personi i tatueshëm ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëpërmjet kërkesës për rimbursim, kerkese e cila depozitohet elektronikisht. Gjithashtu, me kërkesën për rimbursim, përcaktohet shuma që do të kalojë për kompensim të detyrimeve tatimore të papaguara, nëse ka të tilla, përveç detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shumën që do t'i rimburohet nëpërmjet thesarit.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nëpërmjet strukturave përkatëse të administratës tatimore, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim dhe 30 ditëve për tatimpaguesit eksportues, kryejnë procedurën e rimbursimit sipas këtij udhëzimi dhe miraton tepricën e TVSH-së së zbritshme si të rimbursueshme. Ne fillim te procedures, nese kerkesa gjendet ne perputhje me ligjin, brenda 5 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses nga ana e tatimpaguesit i dergon ketij te fundit nje “Njoftim per pranimin e kerkeses per rimbursim te TVSH-se”. Kur është e nevojshme, sipas analizës së riskut, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, e cila shqyrton kërkesën për rimbursim, si dhe kryen të gjithë procedurën e rimbursimit, i kërkon Drejtorisë Rajonale Tatimore përkatëse të ushtrojë kontroll tatimor përpara miratimit të shumës së rimbursueshme.

Klasifikimi eksportues per efekt rimbursimi TVSH-je

Eksportues për qëllime të këtij udhëzimi konsiderohen eksportuesit e kategorizuar sipas VKM-së nr. 953, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” për qëllime të rimbursimit të TVSH-së.

Nëse sipas kriterëve të VKM-së tatimpaguesi është eksportues me risk zero, për periudhën për të cilën kërkon rimbursim, atëherë kërkesa nuk i nënshtrohet analizës së riskut për rimbursim dhe rimburohet automatikisht.

Falimentimi

Autoritetet tatimore kane detyrimin te dergojne per falimentim te gjitha shoqerite tregtare 3 vjet pasi ato kane kaluar ne regjistrin pasiv

Pranimi i ankimit ndaj nje detyrimi tatimor nga administrata tatimore

Kur një detyrim tatimor është objekt ankimi, ankimi pranohet vetëm në qoftë se ankimuesi

a) paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor, objekt ankimi, të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat minimalisht 6 muaj por jo me pak se afati sipas te cilit vendimi ka marre forme te prere.

Drejtoria e Apelimit Tatimor vendos per ankimin e tatimpaguesit brenda 60 diteve nga data e marrjes se ankimit te plotesuar si duhet. Ne rast se ankimi eshte i paplote afati fillon nga data e plotesimit te dokumentacionit, por jo me vone se 30 dite nga data e marrjes ne dorezim te ankimit per here te pare. Pra ne total koha e shqyrtimit te ankimit nuk mund te kaloje ne asnje rast periudhen prej 90 ditesh.

Gjoba per mosregjistrimi apo mosperditesim te dhenash

Ne rast se tatimpaguesi ushtron veprimtari tregtare ose jofitimpruese pa u regjistruar ne gjykate apo ne QKR, apo nuk perditeson te dhenat, denohet me gjobe ne vleren prej 10,000 Lek.

Gjoba per mospagim ne afat te detyrimit tatimor

Tatimpaguesi, i cili nuk paguan brenda afatit të parashikuar në ligj shumën e detyrimit tatimor, ose të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, apo dorezon nje deklarate tatimore te pasakte ku perfshihet dhe deklarimi i pasakte i teprices kreditore te TVSH-se (diferenca midis teprices kreditore qe duhej deklaruar me tepricen kreditore te deklaruar), detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06 % të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Evazioni tatimor

Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.

Termi “evazion tatimor” përfshin fshehjen apo shmangien me dashje të detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave (p.sh., shitjeve ose të ardhurave të realizuara), falsifikimin e dokumentacionit kontabël dhe tatimor, marrjen e dokumenteve të falsifikuara për të rritur fiktivisht shpenzimet e biznesit ose të TVSH-së së zbritshme duke çuar në përlllogaritjen e pasakte të shumës së tatimit ose taksës. Klasifikimi i një shkeljeje si evazion tatimor duhet të jetë i argumentuar dhe i mbështetur në prova konkrete.

Gjoha per modeklarim punonjesish te punesuar rishtazi

Gjoha per modeklarim punonjesish te punesuar rishtazi mbetet 500,000 Lek per tatimpaguesit e rejigstuar njekohesisht per TVSH-ne dhe tatim fitimin, ndersa per tatimpaguesit e tjere nga 250,000 Lek shkon ne 50,000 Lek. Shkelja e perseritur perben evazion tatimor dhe behet kallezim penal per tatimpaguesin.

Gjoha per mosinstalimin e kases fiskale

a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit:

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë ose që plotësojnë për herë të parë detyrimin ligjor për instalimin e pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit aplikohet një afat prej 15 ditësh pune për vendosjen dhe instalimin e pajisjes fiskale apo sistemit të monitorimit të qarkullimit;

ii) nëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes “i”, më sipër, konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë, ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit;

iii) çdo konstatim i mëpasshëm i mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemit të monitorimit të qarkullimit, si shkelje e përsëritur, konsiderohet evazion tatimor siç parashikohet në nenin 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke bërë kallëzim penal për tatimpaguesin;

b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

ii) për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas verifikimit të parë, ku konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, sipas kërkesave të ligjit, i nënshtrohet një dënimi administrativ me gjobë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi fitimin dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë për tatimpaguesit e tjerë;

iii) për çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, pas aplikimit të dy dënimeve administrative, si më sipër, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin;

g) nuk mban dhe mirëmban në kushte pune pajisjet fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit, me gjobë në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë;

gj) nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale ose sistemin e monitorimit të qarkullimit dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve, me gjobë në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë

Gjobe per mosaplikimin e autonqarkeses se TVSH-se (reverse charge)

Për shkeljet e konstatuara në rastin kur përgjegjës për të aplikuar TVSH-në është personi i tatueshëm blerës nëpërmjet “autongarkesës së TVSH-së”, aplikohen dënimet si më poshtë:

- a) Me gjobë në përputhje me nenin 118 të ligjit, kur ky person nuk ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin për TVSH-në, por moslëshimi i faturës nuk sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.
- b) Me gjobë në përputhje me nenin 124 të ligjit, kur vepron sipas shkronjës “a”, të nenit 128/1, por në këtë rast, moslëshimi i faturës sjell pasoja në TVSH-në e pagueshme.
- c) Me gjobë, në përputhje me pikën 1, të nenit 128 të ligjit, kur ky person ka lëshuar faturë tatimore jo në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin për TVSH-në.
- ç) Me gjobë në përputhje me nenin 115, të ligjit, kur ky person i tatueshëm ka lëshuar faturë me TVSH, sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në dhe nuk e ka deklaruar atë duke sjellë pasoja në TVSH-në e pagueshme.”.

Ligj nr. 91/2015 “Për një shtesë dhe ndryshim në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Rimbursimi tatimor kalon ne kompetence te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve

Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së”.

Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.

Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.”

LIGJ Nr. 99/2015 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Konflikti i interesave ne administraten tatimore

Nëpunësi i administratës tatimore qendrore dhe vendore, që gëzon statusin e nëpunësit civil, ndalohet që të ketë zyrë të kontabilitetit apo të konsulencës fiskale në pronësi të tij apo të afërmeve të tij, deri në shkallën e dytë, sipas Kodit Civil, dhe personave të lidhur, sipas ligjit për konfliktin e interesave.

Kryerja e veprimtarise ne adresa te padeklaruara

Çdo tatimpagues, i cili konstatohet se kryen veprimtari në adresa të padeklaruar, për të cilat nuk ka kryer përditësimin e të dhënave, por mallrat që mban në ruajtje, përdor apo transporton janë të shoqëruara me dokumente tatimore, dënohet me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh

Moskryerja e pageses se mallit nga bleresi

Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë pagesen për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor, në përputhje me këtë ligj.

Moshitja me pakice nga tregtaret me shumice

Deri në datën 31.3.2016, për të gjithë tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave të blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), shitjet me kupon tatimor, të lëshuar nga pajisja fiskale, nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në. Nga data 1 prill 2016, tatimpaguesit, që kryejnë shitje me shumicë të mallrave, nuk lejohen të shesin me kupon tatimor të blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë)

Numrat IMEI

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon Bazën e të Dhënave të numrave IMEI të telefonisë celulare, në të cilën regjistrohen të gjithë numrat IMEI të telefonave celularë në momentin e importimit dhe të gjithë numrat IMEI të telefonave që shiten nga tatimpaguesit në tregun vendas, shitës me shumicë dhe shitës me pakicë, pa cenuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale

Mbajtja e pajisjeve fiskale

Ndalohet mbajtja apo përdorimi i pajisjeve fiskale dhe sistemeve të monitorimit të qarkullimit, të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji

Certifikimi fiskal i pasqyrave financiare

Në rast se tatimpaguesi ka të certifikuar, nga kompani të njohura audituese, pasqyrat financiare dhe deklaratat tatimore ku vërtetohet se janë në përputhje me legjislacionin fiskal, administrata tatimore e përshin këtë element në analizën e riskut të tatimpaguesit

Kryerja e pageses se detyrimit tatimor nga palet e treta

Administrata tatimore njëkohësisht me procedurat e tjera të përcaktuara në këtë kre mund t'i kërkojë palës së tretë të kryejë pagesën e drejtpërdrejtë të çdo shume, që kjo palë i detyrohet tatimpaguesit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të njoftimit palës së tretë

Mospagimi ne afat i kesteve te tatim fitimit

Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin ose kësteve paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, dënohet me gjobë në masën 15 për qind të shumës së kështit për t'u paguar

Mosdeklarimi i pages reale

Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar pagën reale të çdo të punësuar, në organin tatimor, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për rastin e parë të konstatimit.

Shitja e mallrave me shumicë e pashoqeruar me dokumentat tatimore

Tatimpaguesi, që shet mallra me shumicë, që mban në ruajtje, përdor apo transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, dënohet me gjobë në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorej apo transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore dhe rivlerësim tatimor të të ardhurave për një periudhë 6-mujore. Me kërkesë të tatimpaguesit, masa e konfiskimit zëvendësohet me pagesën e menjëhershme të një gjobe, të barabartë me vlerën e tregut për të njëjtin mall.

Amnistia per inventar te padeklaruar

Per të gjithë tatimpaguesit, të cilët me vullnetin e tyre bëjnë vetëdeklarimin e mallit që kanë gjendje pa dokumente tatimore, me anë të një fature të përgatitur nga blerësi, brenda datës 31.12.2015, nuk do të zbatohen penaltetet e përcaktuara per mosleshim fature tatimore. Procedurat e vetëdeklarimit të mallrave gjendje nga tatimpaguesi përcaktohen me Udhëzim të Ministrit të Financave. Tatimpaguesit nuk përfitojnë nga kjo dispozitë, nëse shkelja është konstatuar paraprakisht nga administrata tatimore.”.

Mosleshimi i kuponit tatimor

Nese tatimpaguesi nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

- i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë të barabartë me 100 për qind të detyrimit tatimor, të padeklaruar ose të papaguar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave, që llogariten e paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe rivlerësim tatimor të të ardhurave për 6 muajt e fundit;
- ii) për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas verifikimit të parë, sipas shkronjës “i”, të këtij neni, ku konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, sipas kërkesave të këtij ligji, si më sipër, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116, të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin;
- iii) në rastet kur tatimpaguesi ka lëshuar faturë tatimore, por jo kupon tatimor, dënohet me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

c) lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore/biletë, me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.”.

2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:

“d.1) nuk afishon në një vend të dukshëm, në adresën ku kryen veprimtarinë, një poster që tregon të drejtën e blerësit për të mos paguar për mallrat dhe shërbimet e blera, në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të këtij ligji, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”.

3. Pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) mban ose përdor pajisje fiskale apo sisteme të monitorimit të qarkullimit, të cilat nuk janë në përputhje me këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të tij, dënohet me konfiskim të mallrave gjendje. Gjithashtu, në përputhje me nenin 116, të këtij ligji, administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin.

Moslëshimi i fatures apo defteses tatimore

Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të detyrimit tatimor, të padeklaruar ose të papaguar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave, që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji e të ligjeve specifike tatimore.

Moslëshimi i fatures apo defteses tatimore nga shitesi me shumice

Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH nga tatimpaguesi që shtet mallra me shumicë dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të detyrimit tatimor, të padeklaruar ose të papaguar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore e interesave, që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji e të ligjeve specifike tatimore, me gjobë në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë dhe rivlerësim të të ardhurave për një periudhë 6-mujore.

Gjohitja e audituesit per certifikim fiskal

Në rast se nga kontrolli i bërë nga administrata tatimore tek tatimpaguesit, pasqyrat financiare të të cilëve janë certifikuar nga kompanitë audituese se janë në përputhje me legjislacionin fiskal, rezultojnë detyrim tatimor, masa e detyrimit tatimor i ngarkohet e plotë tatimpaguesit, ndërsa kompania certifikuese dënohet me një gjobë me masën e detyrimit tatimor që i ngarkohet tatimpaguesit

Mosngarkimi i numrave IMEI

Çdo tatimpagues që nuk ngarkon të dhënat e numrave IMEI të telefonave celularë ose ngarkon informacion të pasaktë dënohet me një gjobë prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekësh për çdo mosngarkim/ngarkim jo të saktë

Udhëzim nr. 24, datë 11.09.2015: Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”

Në vlerësimin e automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në buletin, vlera nuk mund të llogaritet më pak se:

17.1 Për autoveturat:

- a) Deri 1400 cc, jo më pak se 130.000 lekë;
- b) Mbi 1400-1900 cc, jo më pak se 200.000 lekë;
- c) Mbi 1900-2500 cc, jo më pak se 325.000 lekë;
- d) Mbi 2500-3000 cc, jo më pak se 400.000 lekë;
- e) Mbi 3000-4500 cc, jo më pak se 500.000 lekë;
- f) Mbi 4500 cc, jo më pak se 800.000 lekë.

17.2 Kamionçina, furgonë dhe kamionë:

- a) Deri në 1.5 tonë, jo më pak se 400.000 lekë;
- b) Nga 1.5 tonë deri në 3.5 tonë, jo më pak se 600.000 lekë;
- c) Nga 3.5 tonë deri në 10 tonë, jo më pak se 850.000 lekë;

d) Nga 10 tonë deri në 15 tonë

jo më pak se 1.000.000 lekë;

c) Mbi 15 tonë, jo më pak se 1.200.000 lekë

UDHËZIM Nr. 9, datë 27.2.2015 “MBI MARRËVESHJET E ÇMIMIT NË AVANCË”

Ne perputhje me rregullat dhe procedurat për zbatimin e nenit 36/7, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, “Marrëveshje çmimi në avancë” (MÇA) është një marrëveshje procedurale ndërmjet një apo më shumë tatimpaguesve dhe një apo më shumë administratave tatimore, me qëllim zgjidhjen në avancë të mosmarrëveshjeve të mundshme të transferimit të çmimit, duke përcaktuar para kryerjes së transaksioneve të kontrolluara, një grup kriteresh të përshtatshme për përcaktimin e përputhshmërisë së këtyre transaksioneve me parimin e tregut.

2.1 Llojet e marrëveshjeve që mbulohen nga ky udhëzim përfshijnë:

a) Marrëveshjet e njëanshme të çmimit në avancë, përmes të cilave lidhet një marrëveshje ndërmjet një tatimpaguesi dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) në lidhje me zbatimin e nenit 2 (4), neneve: 36-36/7 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, për transaksionet e kontrolluara të specifikuar;

b) marrëveshjet dypalëshe të çmimit në avancë, përmes të cilave një tatimpagues kërkon që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të arrijë marrëveshje me një partner të konventës së shmangies së tatimit të dyfishtë (autoriteti tatimor i shtetit tjetër kontraktues) në lidhje me zbatimin e nenit të ndërmarrjeve të lidhura të konventës përkatëse të shmangies së taksimit të dyfishtë në transaksionet e kontrolluara të specifikuar;

c) marrëveshjet shumëpalëshe të çmimit në avancë, përmes të cilave një tatimpagues kërkon që Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve arrin marrëveshje me dy apo më shumë partnerë të konventës së shmangies së tatimit të dyfishtë në lidhje me aplikimin e neneve të ndërmarrjeve të lidhura për transaksionet e kontrolluara të specifikuar.

UDHËZIM Nr. 4, datë 30.9.2015 PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, PËR VITIN 2015

Sipas vleresimit të Entit Kombëtar të Banesave, kostoja mesatare e ndërtimit të ndërtesave në shkallë Republike, për vitin 2015, është 39.587 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/m², për sipërfaqe shfrytëzimi.

Vendimi 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”

Në këtë vendim ndryshon mënyra e përlogaritjes së qerave.

Në kontratën e qerave duhet të përcaktohet qartë adresa ku ndodhet ndërtesa, sipërfaqja në metër katrorë dhe vlera mujore e qerasë së objektit.

Në asnjë rast, vlera e dhënies me qira të ndërtesës nuk do të jetë më e vogël se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në këtë vendim, si me poshte:

(i) Vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe apartament banimi, zyre apo magazine të dhënë me qira, është e barabartë me:

- 0.3 për qind të çmimit të shitjes së apartamentit të banimit, e përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

(ii) Vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe për:

- dyqan mallrash ose shërbimesh është dyfishi i pikes (i),
- parkim i mbyllur 70 për qind/parkim i hapur 30 për qind e pikes (i).

Noteret janë ngarkuar me zbatimin e kushteve të mesipërme duke dërguar kontratat e qerave të lidhura në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda datës 5 të çdo muaji.

VENDIM Nr. 434, datë 20.5.2015 PËR PËRCAKTIMIN E NORMATIVAVE PËR FIROT, HUMBJET, DËMTIMET DHE SKARCOT GJATË PRODHIMIT, MAGAZINIMIT, TRANSPORTIMIT ETJ., TË NJOHURA PËR QËLLIME FISKALE

- Firo, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë procesit të prodhimit, magazinimit apo transportimit, për produktet që janë subjekt i akcizës, përcaktohen sipas vendimit nr.612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

- Për industrinë prodhuese, që përdorin lëndë djegëse në procesin e prodhimit, normativat e lëndëve të para djegëse përcaktohen sipas vendimit nr.612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

- Për duhanin, firo dhe humbjet në procesin e përpunim-manipulimit përlogariten sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr.687, datë 18.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e nivelit të firove të lejuara gjatë procesit të përpunim-manipulimit të duhanit”.

- Për humbjet dhe firo në procesin e prodhimit, për të cilat nuk ka akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, sasia dhe vlera e lejuar e tyre do të llogariten duke u bazuar në kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit.

Autoritetet tatimore, gjatë kontrollit të ushtruar në vend pranë tatimpaguesit, analizojnë kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit, që shoqërojnë makinerinë apo linjat përkatëse nga prodhuesi i tyre dhe kryejnë verifikimet lidhur me nivelin e humbjeve të pësuar gjatë procesit të prodhimit/përpunimit. Për matjen e nivelit të humbjeve gjatë prodhimit, inspektorët tatimorë mbajnë procesverbalin përkatës, të firmosur edhe nga drejtuesi teknik apo administratori, të cilin ia bashkëlidhin aktit të kontrollit.

Nëse karta teknologjike përcakton norma të amortizimit të makinerive, në varësi të përmbushjes së orëve të punës, atëherë tatimpaguesi, me përmbushjen e këtyre orëve, si pasojë e konsumit apo amortizimit të linjës së prodhimit, duhet të paraqesë një kërkesë për ndryshim të normave të lejuara të humbjeve në prodhim. Kërkesa paraqitet pranë institucioneve përgjegjëse për konfirmimin e kartave teknologjike.

Nuk do të njihen firo për transportim apo magazinim, me përjashtim të rasteve të produkteve të akcizës të përcaktuara në vendimin nr.612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

Për energjinë elektrike, humbje gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike e përcaktuar në vendimin nr.171, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”.

Brenda 45 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo tatimpagues duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore dokumentacionin për miratimin e firove, ku të përfshihen:

- a) karta teknologjike;
- b) përshkrimi i detajuar i procesit të prodhimit;
- c) planimetria e objektit;
- ç) normativat e konsumit të lëndës së parë dhe të orëve të punës për njësi produkti të gatshëm (karta teknologjike), shoqëruar edhe me të dhënat për:
 - llojin e lëndës së parë, të përdorur në procesin e prodhimit;
 - fazat, në procesin teknologjik, ku përdoret lënda e parë.

Karta teknologjike duhet të jetë e konfirmuar/certifikuar nga një institucion i njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Inspektorati Shtetëror përgjegjës dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, institucione që miratojnë karta të ndryshme teknologjike apo çdo institucion tjetër që ka aftësitë dhe lidhet me proceset teknologjike përkatëse

LIGJ Nr. 6/2015 dt. 12.02.2015.PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10081, DATË 23.2.2009, “PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Nr.	Nr. i fushës/kategori	Lloji i kategorisë	Fusha/kategoritë e veprimtarive dhe/ose të të mirave publike e të përdorimeve të tyre
	Fusha I		Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile
1	1.	Licencë	Prodhimin dhe/ose tregtimin i mallrave (armë, municione, lëndë, pajisje, teknologji etj.) ushtarake dhe/ose me përdorim të dyfishtë
2	2.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile
3	3.	Licencë	Shërbimi privat i sigurisë fizike
	Fusha II		Ushqimi dhe shëndeti
4	1.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
5	2.	Licencë	Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinarë
6	3	Licencë	Rritja ose tregtimi i kafshëve
7	4.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve
8	5.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
9	6.	Licencë	Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
10	7.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë
11	8.	Licencë	Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjiëno-sanitare
	Fusha III		Mjedisi dhe burime mjedisore bazë
12	1.	Leje	Për ndikimin në mjedis
13	2.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
14	3.	Licencë	Importi i mbetjeve për qëllim riciklimi, përpunimi, dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozon-holluese
15	4.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose kultivimi i florës (tokësore dhe/ose ujore)
16	5.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose mbarështimi i faunës (tokësore ose ujore)
17	6.	Leje	Shfrytëzimi i ujërave mbi dhe/ose nën/tokësore dhe/ose baseneve e materialeve të tyre
18.	7	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë

	Fusha IV		Burime minerare, hidrokarbure dhe energjetike
19	1.	Leje	Minerare ose hidrokarbure
20	2.	Leje	Për të gjitha rastet që burojnë nga legjislacioni për koncesionet
21	3.	Leje	Rastet dhe llojet e tjera të përdorimit të burimeve me natyrë energjetike
22.	4.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushë
	Fusha V		Territori dhe ndërtimi
23	1.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me zhvillim e territorit dhe/ose ndërtimin
24	2.	Leje	Zhvillimi territorial dhe/ose ndërtimor
	Fusha VI		Trashëgimia kulturore
25	1.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me trashëgiminë kulturore
26	3.	Leje	Restaurim dhe/ose rjetëzimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore
27	4.	Licencë	Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit
	Fusha VII		Transporti
28	1.	Licencë	Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve
29	2.	Licencë	Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë
30	3.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor
31	4.	Licencë	Transport ndërkombëtar detar i automjeteve dhe/ose udhëtarëve

32	5.	Licencë	Për shërbime portuale
33	6.	Licencë	Për shërbime hekurudhore
34	7.	Licencë	Për shërbime aeroportuale
	Fusha VIII		Industri dhe shërbime të tjera
35	1.	Licencë	Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri
	Fusha IX		Arsimi dhe shkenca
36	1.	Licencë	Arsimi parauniversitar
37	2.	Licencë	Arsimi i lartë
	Fusha X		Kujdesi shoqëror dhe punësimi
38	1.	Licencë	Shërbime të kujdesit shoqëror
39	2.	Licencë	Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose formimit profesional
	Fusha XI		Drejtësia dhe ligji
40	1.	Licencë	Shërbimi i Noterisë
41	2.	Licencë	Shërbimi i Përmbaramit
42	3.	Licencë	Shërbime të tjera ekspertize ose profesionale të lidhura me të drejtat civile dhe/ose penale
	Fusha XII		Financat publike
43	1.	Licencë	Për trajtime të favorizuara fiskale dhe/ose doganore
44	2.	Licencë	Shërbime ekspertize ose profesionale financiare apo shërbime të lidhura me financat publike

45	3.	Licencë	Organizimi i lojërave të fatit
----	----	---------	--------------------------------

Ligji nr. 67/2015 “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave”.

Në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave për emetimin e instrumentit “Eurobond”, në përputhje me ligjin nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Mbajtësit e titujve të eurobondeve dhe menaxherët bashkëdrejtues, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen dhe tregtimin e eurobondeve.

LIGJ Nr. 54/2015 Date 28.5.2015 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9789, DATË 19.7.2007, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZONAVE EKONOMIKE

Zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik përfitojnë lehtësitë e mëposhtme fiskale:

- a) hyrja dhe dalja e mallrave në/nga zona, formalitetet dhe procedurat bëhen sipas dispozitave të Kodit Doganor;
- b) zhvilluesit dhe përdoruesit përjashtohen nga pagesa e 50 përqindëshit të normës së tatimitimit për 5 vitet e para, nga fillimi i veprimtarisë së tyre në zonë;
- c) zhvilluesit që investon në zonë, brenda 3 viteve nga data e fillimit të punimeve, ose përdoruesit që investon në zonë, brenda 3 viteve nga fillimi i veprimtarisë ekonomike të zonës, i njihen si shpenzime të zbritshme, të periudhës tatimore, 20 për qind e shpenzimeve kapitale vjetore, pavarësisht nga shumat e amortizimit, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, për një periudhë 2-vjeçare;
- ç) furnizimi i mallrave shqiptare, të destinuara për t’u vendosur në zonë, konsiderohet si furnizim për eksport me shkallë zero, në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe legjislacionit doganor;
- d) projekti i zhvilluesit përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;
- dh) ndërtimet e realizuara në këtë zonë, sipas projektit të zhvilluesit, përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë pesëvjeçare;
- e) zhvilluesit ose përdoruesit e zonës janë të përjashtuar nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;
- ë) shpenzimet për paga dhe kontributet shoqërore e shëndetësore, që punëdhënësi paguan për punëmarrësit, njihen 150 për qind të vlerës gjatë vitit të parë fiskal të ushtrimit të aktivitetit. Në vitet në vijim, shpenzimet shtesë për pagat, në raport me vitin paraardhës, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura me 150 për qind të vlerës;

f) kostot e trajnimit të punonjësve në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura të periudhës tatimore me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike;

g) shpenzimet për kërkim shkencor dhe zhvillim njihen si shpenzime të njohura me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike.

Transferimi i një veprimtarie ekzistuese në territorin shqiptar në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim kryesor përfitimin e lehtësive të parashikuara në këtë ligj, është i ndaluar. Çdo transaksion, që në thelb rezulton në transferimin e veprimtarisë ekonomike, sipas përcaktimit të mësipërm, ndalohet.

Nëse produktet dalin nga zona për shitje në tregun e brendshëm, me një çmim nën çmimin normal për produktin në fjalë, ose produkte të ngjashme apo të zëvendësueshme në mënyrë direkte, dhe kur i shkaktohet dëm material industrisë vendase, ministria përgjegjëse për ekonominë aplikon një tarifë korrektimi të vlerës së munguar mbi produktin në fjalë. Ministria përgjegjëse për ekonominë ngarkohet për zbatimin e këtij mekanizmi korrektues.

produktet e transportuara nga një zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në një tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk janë subjekt i detyrimeve doganore dhe/ose tatimore

Të drejtat, detyrimet dhe lehtësitë fiskale, të përcaktuara në këtë kre, aplikohen për zhvilluesin nga data e fillimit të punimeve, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e institucionit përgjegjës me zhvilluesin

UDHËZIM Nr. 15, datë 18.5.2015 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT NGA ÇDO PERSON NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN TATIMORE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), për qëllime të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet tatimore dhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat parashikojnë asistencë administrative në çështjet tatimore dhe janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kërkon informacion ndaj/dhe për çdo person, përfshirë, por pa u kufizuar, në informacionin e mbajtur nga banka dhe institucione të tjera financiare.

Në rast të paraqitjes së një kërkesë në zbatim të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi, nga një autoritet tatimor i një shteti tjetër me të cilin ka një marrëveshje ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga autoriteti i huaj, i drejton një kërkesë me shkrim personit, i cili disponon informacionin e kërkuar. Në kërkesë specifikohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit për të cilin kërkohet informacioni për qëllime tatimore, periudha dhe arsyeja e kërkesës së këtij informacioni.

Me marrjen e informacionit të kërkuar, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 7 ditëve, i kthen përgjigje autoritetit tjetër tatimor.

LIGJ Nr. 8/2015 Dt. 19.02.2015 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9723, DATË 3.5.2007, "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT", TË NDRYSHUAR

Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji. Dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen edhe në format elektronik, sipas parashikimeve të kreut VI. Dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë sporteleve të shërbimit në kopje të panjësuar apo në format elektronik bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet në nenin 32, të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit të nënshkruar, ndarja e kapitalit në një numër kuotash të barabartë me numrin e ortakëve, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo

Regjistrimet e detyrueshme : pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme

Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, pranë çdo sporteli shërbimi, kërkime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve
